



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Në bazë të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 paragrafi 5.2. të Ligjit Nr.03/L-138 Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.2004/5 Për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 08/ 2010

**MBI KAKTIMIN E LARTËSISË SË TAKSAVE PËR LICENCIMIN E
SUBJEKTEVE NGA SEKTORI I NAFTËS DHE DERIVATET E NAFTËS**

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet lartësia e taksave të cilat i paguajnë subjektet për aplikim, licencim dhe përfitjen të licencës në sektorin e naftës e që kanë të bëjnë me importin, deponimin, shitjen me pakicë dhe shumicë të naftës dhe derivateve të saj në Kosovë për shërbimet e ofruara nga Zyra e Licencimit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë

Neni 2
Lartësia e taksave

1. Përcaktohet lartësia e taksave për secilin lloj të licencave dhe përtëritjen e tyre, si vijon:

Lloji licencës	Shuma
1.1. Licencë për import të naftës dhe benzinës për konsum të përgjithshëm.....	5,000.00 €;
1.2. Licencë për deponim të naftës dhe benzinës për konsum të përgjithshëm.....	1,500.00 €;
1.3. Licencë për shitje me shumicë të naftës dhe derivateve të saj.....	3,000.00 €;
1.4. Licencë për shitje me pakicë të naftës dhe derivateve të saj	1,500.00 €;
1.5. Licencë për import të LPG-së	2,000.00 €;
1.6. Licencë për deponim të LPG-së	1,500.00 €;
1.7. Licencë për shitje me shumicë të LPG-së	2,000.00 €;
1.8. Licencë për shitje me pakicë të LPG-së	500.00 €;

1

1.9. Licencë për import të vajrave të rënda sipas produktit të caktuar (mazut, solar, bitumen i lëngëzuar).....	2.000.00 €;
.....
1.10. Licencë për shitje me shumicë të vajrave të rënda.....	2.000.00 €;
1.11. Licencë për import të vajrave, sipas produktit të caktuar (lubrifikante, motorike dhe bazike)....	2.000.00 €;
1.12. Licencë për shitje me shumicë të vajrave.....	2.000.00 €;
1.13. Licencë për import të petrolkoksit	1.000.00 €;
1.14. Licencë për transport të naftës dhe derivateve të saj	1.000.00 €;
1.15. Licencë për import të kerozinës.....	3.000.00 €;
1.16. Licencë për deponim të kerozinës.....	1.500.00 €;
1.17. Licencë për shitje me shumicë të kerozinës.....	2.000.00 €;
1.18. Licencë për import të naftës industriale.....	3.000.00 €;
1.19. Licencë për import të naftës për përpunim të mëtejshëm	3.000.00 €;
1.20. Licencë për import të bombolave të gazit për amvisni.....	300.00 €;

Neni 3

Lartësia e taksës për përtrirje të licencës

Për përtrirje (rilicencim) subjektet paguajnë taksën në lartësi prej 50 % të taksës së përcaktuar me nenin 2 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 4

Subjektet me rastin e parashtrimit të aplikacionit për licencim apo rilicencim (përtrirje) paguajnë taksën në lartësi prej 50,00 €.

Neni 5

Pagesa e taksës për marrje të licencës në lartësinë e përcaktuar sikurse në nenin 2 dhe 3. të këtij Udhëzimi Administrativ, bëhet pas marrjes së vendimit nga ana e Zyrës mbi lëshuarjen e licencës.

Neni 6

1. Taksat e përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ paguhen përmes llogarisë bankare, të shoqëruara me një kopje të fletëpagesës e cila dorëzohet si dëshmi në Zyrën e Licencimit.
2. Të gjitha të hyrat e realizuara nga pagesa e taksave janë të hyra publike dhe derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 7

Dispozitat kalimtare dhe shfuqizuese

Të gjitha aplikacionet për licencim dhe përtrirje të licencës e që janë dorëzuar në Zyrën e Licencimit para hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ do të vendosen sipas tarifave që kanë ekzistuar deri në hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ.



Neni 8
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Tregtisë dhe Industrisë.

Prishtinë, 28.04.2010



Ministri i Tregtisë dhe Industrisë
Lutfi ZHARKU